

Të nderuar të pranishëm

I nderuar ambasador i Italisë, Andrea Silvestri

Në emrin tim dhe në emër të Ministrisë së Kulturës, ju uroj suksese dhe urime të gjithë pjesëmarrësve në prezantimin e këtij viti të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ekspozitën më prestigjioze në botë, Bienalen e Artit në Venecia.

Shpreh falënderim për angazhimin kundrejt anëtarëve të Komisionit që vlerësuan aplikimet (Nebojsa Viliq, Diana Tomiq-Radevska, Nevzat Bejtuli Kica), komisioneres Dita Starova-Qerimi dhe Galerisë Kombëtare, kuratoreve Ana Frangovska dhe Sanja Kojiq Mladenov. Natyrisht, urimet më të sinqerta për autorët e projektit - Robert Jankuloski dhe Monika Moteska.

Falënderoj edhe autorët dhe institucionet e tjera që morën pjesë në Konkurs. Të gjitha këto vepra të krijuara për Bienalen e këtij viti, mbeten dëshmi e përhershme e momentit aktual në artin bashkëkohor maqedonas.

Bukuria dhe afirmimi i artit vendas të megangjarjeve të tilla sjell përgjegjësi të madhe dhe kërkon profesionalizëm të lartë.

Të gjithë të përfshirët në evente të këtij rangu gjithmonë, japin maksimumin e tyre sepse del në shesh së bashku me artistë nga vendet më të pasura dhe më të zhvilluara nga e gjithë bota. Përballë tyre, Bienalja e Venecias prezanton gjithmonë kultura të reja, më të vogla, të cilat në mënyrë autentike artistike janë provokim për botën e artit. E gjithë kjo e bën këtë përmbledhje vizuele një nga ngjarjet më me ndikim të artit në fushën e tij.

Çdo kulturë rritet në kontekstin e ngjarjeve botërore. Shpreh kënaqësinë që Maqedonia e Veriut është vazhdimisht e pranishme në Veneci, si në art ashtu edhe në Bienalen e arkitekturës. Kjo për ne si vend dhe për të gjithë artistët e vendit është motiv i madh për të bërë gjithçka për të qenë përfaqësues të denjë në familjen e bashkuar ndërkombëtare të artit bashkëkohor të shekullit të 21-të.

Bienalja e Venecias shtron tema dhe kërkon përgjigje. Edhe në këto kohë të paparashikueshme, arti mbetet pjesë e angazhuar e tendencave shoqërore, ndriçon çështje jo shumë të këndshme, komenton, paralajmëron. Me këtë veprim,parashikon mjedis më falënderues për njerëzimin, edhe kur flet për luftëra, pandemi ose lloj krizash të tjera.

“Landscape Experience” është imazhi ynë në botë në 7 muajt e ardhshëm. Pavijoni maqedonas do të jetë i hapur dhe i vlerësuar nga publiku kritik më preciz dhe publiku më i gjerë. Jam e bindur se projekti, si ideologjikisht ashtu edhe produktivisht, edhe me pyetjet që nxit, do të ngjallë reflektim dhe do të tërheqë interes. Shfaqjet tona në Venecia nuk janë inferiore. Ato kanë rëndësi të madhe për të gjithë ne në ruajtjen e marrëdhënieve me vendet e botës, përmes fushës së artit që krijon miqësi të pathyeshme.

„Qumshti ëndrave” dhe „Landscape Experience” do të mbahen mend si temë dhe vepra e krijuar gjatë disa krizave botërore. Këto vepra do të dëshmojnë për artistin përballë pyetjeve të mbijetesës së racës njerëzore, të identitetit të humbur, të transformimeve dhe mutacioneve. Arti këtë vit provokohet për të ndihmuar politikën, për të thirrur të mirën përmes së keqes, për të kërkuar bashkimin, mirëkuptimin.

Të nderuar artistë, kuratorë, komisioner, ju uroj prezantim të suksesshëm të Bienales së Venecias, gëzim, kënaqësi, dhe zhvillim të skenës së artit bashkëkohor në Maqedoninë e Veriut. Ju jeni pjesë e artistëve të elitës botërore dhe përmes temës së Bienales së këtij viti po na tregoni këtu dhe botës se arti dhe artistët mund të na ndihmojnë të imagjinojmë mënyra të reja dhe mundësi pafundësisht të reja për një botë më të mirë.

Me fat!

Faleminderit për vëmendjen.